



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 29

Prishtinë, më 29.4. 2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS**

Në mbledhje morën pjesë: Fadil Demaku, nënkryetar i parë; Bojan Mitiq, nënkryetar i dytë, Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami dhe Nuredin Ibishi, anëtarë.

Munguan: Daut Haradinaj, Rexhep Selimi dhe Zafir Berisha.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Përfaqësuesit nga Ministria e Forcës së Sigurisë së Kosovës: Haki Demolli, ministër i Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Pjesëmarrëse tjetër: Luanda Domi- DCAF.

Mbledhjen e kryesoi, Fadil Demaku, nënkryetar i parë i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

Raportimi i Ministrit të Ministrisë së Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Haki Demolli

Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

Kryesuesi- Fillimisht falënderoi ministrin për përgjigjeje për të qenë prezent në Komision, pasi qëllimi i këtij takimi ishte që të kemi informacione për zhvillimet e fundit në FSK, procesin e transformimit të FSK-së në Forca të Armatosura, si dhe vizitën e realizuar në SHBA, bashkë me komandantin e FSK-së. Fjalën ia dha ministrit.

Haki Demolli- Ministër i Ministrisë së FSK-së- Fillimisht falënderoi për ftesën e bërë për të qenë prezent në Komision. Sa i përket vizitës në SHBA-, theksoi se kjo vizitë ka zgjatur nga data 19 prill deri më 27 prill 2016 dhe se në të gjitha takimet prezent ka qenë edhe komandanti i FSK-së, z. Rrahman Rama, si dhe Ilir Qeriqi, drejtor për Bashkëpunimin Ndërkombëtar në Ministrinë e FSK-së, ambasadorja e Republikës së Kosovës, znj. Vlora Çitaku, atasheu ushtarak z. Xhavit Gashi, si dhe koloneli-atasheu i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, ndërsa në disa takime ka qenë gjenerali Jor, që është komandant i Gardës së Ajovës.

Takimet kryesore janë mbajtur në Pentagon, State Departament dhe në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, ndërsa zyrtarët amerikanë që janë takuar gjatë kësaj vizite janë, gjenerali Frank Gros, shef i Gardës Nacionale të Ajovës, dr. Michael Carpetner- zëvendësasistent i Sekretarit të Shtetit, Mark Lorenc, drejtor për NATO dhe Victoria Taylor, drejtor për Ballkanin. Ndërsa takimi bilateral i udhëhequr nga koloneli Lempton, është biseduar për bashkëpunimin në çështjet e sigurisë. Në të gjitha takimet është dhënë informacioni nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së FSK-së, rreth zhvillimeve në FSK. Temë kyçe e diskutimit ka qenë vizioni i Ministrisë së FSK-së, bashkëpunimi rajonal, ku është shprehur interesimi për anëtarësimin në iniciativat rajonale të sigurisë, siç është Karta e Adriatikut A-5, si dhe anëtarësimi në mekanizmat e tjerë të sigurisë dhe është shprehur interesimi për të bashkëpunuar me ministrinë homologe të rajonit. Gjithashtu është diskutuar çështja e bashkëpunimit të FSK-së me NATO-n, ku është theksuar bashkëpunimi me dy ekipet këshilluese të NATO-s. Po ashtu kemi theksuar kërkesën e drejtuar nga ana e Kryeministrit të Republikës së Kosovës për ngritjen e bashkëpunimit dhe dialogut në nivel politik, si dhe për mundësin e hapjes së zyrës ndërlidhëse të Kosovës në NATO. Gjithashtu është theksuar për bashkëpunimin që ekziston në mes të FSK-së dhe KFOR-it.

Temë tjetër e rëndësishme që është diskutuar, ka qenë bashkëpunimi mes Ministrisë së FSK-së dhe SHBA-së, të cilat i konsiderojmë partner strategjik për FSK-në dhe ministrinë, ku është vlerësuar si një ndër partneritetet më të suksesshme bashkëpunimi me Gardën Nacionale të Ajovës, si dhe për shkollimin e kuadrove nga radhët e FSK-së, ku tashmë janë pranuar dy kadet nga radhët e FSK-së në ËestPoint, akademinë më prestigjioze ushtarake.

Temë tjetër e diskutimit ka qenë edhe procesi i transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur dhe për këtë çështje është njoftuar se ministria është duke e respektuar mandatin kushtetues të FSK-së dhe pavarësisht këtij fakti janë bërë përgatitjet për procesin e transformimit, proces i cili është transparent ku janë të përfshira edhe ekipet këshilluese të NATO-së, ekipet këshilluese të Gardës së Ajovës, atasheu i Mbrojtjes nga Ambasada Amerikane dhe komandanti i KFOR-it, ndërsa në nivel vendor janë njoftuar Presidenti, Kryeministri dhe Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, si dhe ka pasur tentativa për të pasur takime me ministrat që janë nga radhët e Listës Serbe dhe në ditët në vijim do të realizohet takimi për të informuar lidhur me procesin e transformimit.

Në kuadër të Ministrisë së FSK-së është formuar departamenti për transformimin, funksioni i të cilit është të mbikëqyrë transformimin e FSK-së. Gjithashtu janë përcaktuar perimetrat e transformimit siç janë: Periudha e procesit të transformimit, që përfshinë periudhën dhjetë vjeçare, rritja e personelit, buxhetit, infrastruktura dhe procesi i trajnimit.

Gjithashtu është njoftuar që ministria ka përgatitur Projektligjin për transformimin e FSK-së në FAK dhe amendamentet të cilat i janë përcjellë Kryesisë së Kuvendit dhe pritët për vendimin politik për këtë çështje.

Gjithashtu është njoftuar edhe për bashkëpunimin bilateral me shtetet e rajonit dhe vendet e tjera të Evropës, gjithashtu kemi njoftuar që në vendete rajonit dhe të Evropës ka kadetë nga radhët e FSK-së të cilët shkollohen, si dhe për Konferencën vjetore të FSK-së, po ashtu edhe për ushtrimet fushore të FSK-së, etj.

Në mbyllje të fjalës së tij theksoi vlerësimet e dala nga kjo vizitë. Më tutje theksoi se është vlerësuar që bashkëpunimi në mes të Ministrisë së FSK-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes Amerikane, është bashkëpunim pozitiv, duke theksuar bashkëpunimin me Gardën Nacionale të Ajevës dhe Ministrisë së FSK-së.

Është kërkuar që të thellohet dhe intensifikohet ky bashkëpunim edhe më tutje, dhe për këtë qëllim është kërkuar që të kemi dy takime vjetore bilaterale. Gjithashtu është theksuar përkrahja e SHBA-së, për anëtarësimin e Kosovës në Kartën e Adriatikut A-5, pasi Kosova aktualisht është në cilësinë e mysafirit në këtë mekanizëm. Po ashtu është theksuar përkrahja e SHBA-së në zhvillimin e të gjitha proceseve në kuadër të Ministrisë së FSK-së, duke përfshirë edhe procesin e transformimit. Në mbyllje është theksuar që bashkëpunimi me Ministrinë e FSK-së është njëri nga prioritetet e SHBA-së.

Kryesuesi- Falënderoi ministrin për këtë paraqitje dhe fjalën ua dha anëtarëve të Komisionit.

Nuredin Ibishi- Fillimisht shprehi konsideratën lidhur me treguesit e lartë të dalë nga publikimet e disa organizatave të Shoqërisë Civile, lidhur me besueshmërinë e qytetarëve ndaj FSK-së dhe mekanizmave të tjerë të sigurisë, por theksoi që si ministri duhet të kenë kujdes në zbatimin e Ligjit të Prokurimit, pasi siç është parë, ka pasur disa keqpërdorime në blerjen e automjeteve, dhe se këto çështje janë identifikuar në publikimet e organizatave të Shoqërisë Civile. Prandaj inkurajoi që kjo situatë të tejkalohet dhe që mos të ketë kritika lidhur me këtë çështje.

Anton Quni- Falënderoi dhe vlerësoi njoftimin e paraqitur nga Ministri. Më tutje theksoi që duke ditur që kemi ngecje në zhvillimin e kuadrove dhe emërimin e tyre në pozicione të larta në kuadër të FSK-së. Lidhur me këtë shtroi pyetjet si vijon: Si mendoni të menaxhoni në të ardhmen çështjen e emërimeve të larta në FSK? A do të jeni në gjendje, që emërimet të bëhen duke vlerësuar performancën dhe profesionalizmin që posedon FSK-ja?

Bojan Mitiq- Duke iu referuar fjalës së ministrit, z. Demolli, që janë lajmëruar komuniteti serb, shtroi pyetjen: Për çka janë njoftuar dhe çka është biseduar me ta? A janë zhvilluar bisedime me përfaqësuesit serbë në kuadër të Qeverisë për këtë çështje? Më tutje konsideroi se është e rëndësishme të bisedohet me ta, pasi janë ata që duhet të përkrahin projektligjin për transformimin e FSK-së.

Qerim Bajrami- Theksoi që komuniteti boshnjak në Kosovë e përkrah procesin e transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur dhe vlerësojnë që të gjitha proceset e lidhura me këtë transformim, do të përkrahen nga komuniteti boshnjak. Më tutje theksoi që si komunitet i tretë në Kosovë, duhet të kemi një vend të veçantë edhe në përbërjen e tanishme të FSK-së, por edhe në të ardhmen në Forcë të Armatosur. Sa i përket kësaj, do të kërkoj nga Komisioni që të marrim përgjigjeje me shkrim nga Ministria e FSK-së lidhur me përfaqësimin e këtij komuniteti që t' i

kemi shënimet dhe email adresat e përfaqësuesve të komunitet boshnjak, në mënyrë që të kemi të dhëna për këtë komunitet, pasi sipas informacionit që ka, mund të jenë 42 ose 52 pjesëtarë nga ky komunitet dhe se të dhënat do t'i heqin dyshimet për këtë çështje. Ndërsa sa i përket kërkesës së bërë nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për hapjen e një zyre ndërlidhëse në NATO, e konsideroi si diçka pozitive. Më tutje shtroi pyetjen, se në rast të mos transformimit të FSK-së, a do të ketë bashkëpunim mes FSK-së dhe NATO-së në ngritjen e kapaciteteve në kuadër të FSK-së?

Haki Demolli, ministër i Ministrisë së FSK-së- Në përgjigjeje të pyetjes, lidhur me zbatimin e Ligjit të Prokurimit, theksoi se si ministër ka insistuar që të zbatohet ligji në procesin e prokurimit në kuadër të Ministrisë së FSK-së. Më tutje njoftoi që për këtë vit është planifikuar blerja e njëzet e shtatë automjeteve taktike, tre automjeteve të blinduara dhe disa automjeteve jo taktike, autobusëve dhe dy auto-ambulancave. Duke qenë se kemi ndryshime në Ligjin e Prokurimit, ka mbetur që në ndërkohë të nxjerrët një rregullore, ndërsa për mjetet që kanë diçka speciale dhe që kanë të bëjnë me çështje ushtarake, vetëm për to të shkohet me procedura të negocimit pa publikim të tenderit, por duke mos e anashkaluar ligjin.

Ndërsa sa i përket pyetjes së z. Anton Quni, theksoi se është shqetësuese situata që e ka gjetur, dhe pas ardhjes së komandantit të ri të FSK-së, ka insistuar që të bëhet avancimi i kuadrove ushtarake, konform rregulloreve për zhvillimin e karrierës, dhe të gjithë të trajtohen në mënyrë të barabartë. Më tutje theksoi se këtë çështje e ka diskutuar edhe me Komandantin e FSK-së dhe ekipet këshilluese në kuadër të FSK-së, por është menduar që të pritët procesi i transformimit, por, si ministër, do të insistojë që ngritja profesionale të bëhet në baza meritore pa ngjyrimet politike.

Ndërsa në përgjigjeje të pyetjes së z. Bojan Mitiq, se me kënd kemi biseduar konkretisht, theksoi se, si ministër i FSK-së, ka pasur takime me zëvendëskryeministrin nga radhët e Listës Serbe dhe me ministrin Mariq. Në takimin parë që është mbajtur, nga ana e tyre është shprehur shqetësimi se kanë mbetur të pa informuar për zhvillimin e procesit të transformimit. Për këtë qëllim kam kërkuar përgatitjet e të gjitha dokumentacionit që i referohet procesit të transformimit, siç janë amendamentet kushtetuese, projektligji për transformimin FSK-së, dhe i janë dorëzuar në mënyrë të shkruar. Pas kësaj është realizuar edhe një takim tjetër, ku nga ana e tyre është thënë që do të bisedojnë me njerëz profesionist nga subjekti politik i Listës Serbe. Më tutje është realizuar edhe një takim tjetër, ku prezent kanë qenë, Kryeministri i Kosovës, Presidenti, ministri i FSK-së, komandanti i FSK-së dhe prezent kanë qenë të tre ministrat nga radha e Listës Serbe, dhe është diskutuar për gjetjen e një zgjidhje lidhur me votimin e transformimit të FSK-së në Forcë të Armatosur.

Ndërsa në përgjigjeje të pyetjes së z. Qerim Bajrami, theksoi se sa i përket përfaqësimit të komunitetit boshnjak, theksoi se në total 8.2% janë nga radhët e minoriteteve, ku pjesëtarët e komunitetit serb nuk janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate. Ndërsa, pyetjes se a mund të ketë ndonjë keqpërdorim, theksoi se mbase edhe mund të ketë, pasi në këtë situatë e ka gjetur ministrinë, por theksoi se do të kërkojë nga shërbimet e FSK-së, që të japin emrat, mbiemrat dhe adresat, të oficerëve dhe pjesëtarët e minoriteteve të tjera. Gjithashtu theksoi se mund të ketë pjesëtarë nga martesat të përziera, të cilët mund të jenë deklaruar si boshnjakë, por që nuk ka informacion të detajuar për këtë çështje.

Në mbyllje të fjalës së tij, falënderoi Komisionin për bashkëpunimin dhe shprehi gatishmërinë për të bashkëpunuar edhe më tutje dhe për të njoftuar Komisionin sa herë që të kërkohet.

Kryesuesi- Falënderoi ministrin për bashkëpunimin dhe njoftimin në Komision dhe e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 10:45.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Nënkryetari i parë i Komisionit,

Fadil Demaku